

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 23 numër 2 prill 2021

Data e botimit: 14.4.2021

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 24.3.2021, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 16, datë 24.3.2021, "Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020" 6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 18, datë 24.3.2021, "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a." 7
4. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 1767, datë 31.3.2021, "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit" 8
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 20, datë 7.4.2021, "Për miratimin e rregullores "Për njohjen kontraktuale të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit"" 10
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 21, datë 7.4.2021, "Për disa ndryshime në fondin numizmatik të Bankës së Shqipërisë"" 15
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 22, datë 7.4.2021, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në programin për harmonizimin e vrotimeve të besimit konsumator dhe të biznesit të Komisionit Evropian" 17
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 23, numër 1, mars 2021 18



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 15, datë 24.3.2021

**“PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 0.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 0.10 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 0.9 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI
GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 16, datë 24.3.2021

**“PËR
MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2020”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “I”, dhe të nenit 69, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pasqyrat financiare të miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe opinionit i audituesit të jashtëm, janë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Politikës Monetare.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI
GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 18, datë 24.3.2021

**PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË
FINANCIARE SHITESË NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA
SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1 shkronja "ç", të nenit 54, pika 2 shkronja "b", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shitesë të faktoringut.
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI
ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI
GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

VENDIM
Nr. 1767, datë 31.3.2021

PËR
CAKTIMIN E SHITESAVE MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2, shkronja "b"; nenit 11, pikat 1 dhe 7; nenit 12, pika 3; nenit 14, pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9; dhe nenit 16, pika 1, shkronjat "a", "ç" dhe "d", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (më poshtë, "rregullorja 41/2019"), bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë është 0 për qind, dhe do të përmbushet duke filluar nga data 31 mars 2022.
2. Bankat me rëndësi sistemike (BARS) dhe shtesat përkatëse të kapitalit (SIST), përcaktohen si më poshtë:

BARS	Vlerësimi për SIST-in total	SIST-i për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	1.5 për qind	1.5 për qind
Banka Raiffeisen sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Credins sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Intesa Sanpolo Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind
Banka OTP Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind

3. Shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, zbatohen së bashku me shtesën konservuese të kapitalit (KONS) sipas tabelës 2 të nenit 10, pika 1, të rregullores 41/2019, ku vlera e KONS-it për të gjithë vitin 2022 është në nivelin 1.5 për qind.
4. Shtesat makroprudenciale të kapitalit, sipas pikës 3 të këtij vendimi,

- zbatohen dhe mbahen në nivel institucioni të veçantë (solo basis).
5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
 6. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi m njëherë.

GUVERNATOR
GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 20, datë 7.4.2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR NJOHJEN KONTRAKTUALE TË
KOMPETENCAVE TË ZHVLERËSIMIT DHE KONVERTIMIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të nenit 42, pika 6, dhe nenit 87 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për njohjen kontraktuale të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit" sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI
ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI
GENT SEJKO

RREGULLORE

“PËR NJOHJEN KONTRAKTUALE TË KOMPETENCAVE TË ZHVLERËSIMIT DHE KONVERTIMIT”

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë përmbajtjen e dispozitave kontraktore në lidhje me njohjen kontraktuale të ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit dhe detyrimet për të cilat zbatohet përjashtimi nga përfshirja e kësaj dispozite kontraktore.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a. nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b. nenit 31, pika 3, nenit 42, pika 6, dhe nenit 87 të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, më tej ligji nr. 133/2016.

Neni 4 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:

- a. “marrëveshje përkatëse” nënkupton çdo marrëveshje detyrimi, përfshirë kushtet e një instrumenti të kapitalit, që krijon një detyrim për të cilën zbatohet neni 42, pikat 1 dhe 2, i ligjit nr. 133/2016.

Neni 5 Përmbajtja e dispozitës kontraktuale

Dispozita kontraktuale, të cilën bankat e përfshijnë në një marrëveshje përkatëse, në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016, përfshin sa vijon:

1. njohjen dhe pranimin nga kundërpala që detyrimi mund të jetë subjekt i ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

2. përshkrimin e kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në përputhje me ligjin nr. 133/2016;
3. njohjen dhe pranimin nga kundërpala:
 - a. se nga ushtrimi i kompetencave të përmendura në shkronjën "b" pranon:
 - i. çdo ulje në shumën e principalit ose shumën e papaguar të mbetur, përfshirë çdo interes të përlogaritur, por të papaguar, në lidhje me detyrimin e bankës sipas marrëveshjes përkatëse,
 - ii. konvertimin e këtij detyrimi në aksione të zakonshme ose instrumente të tjera të pronësisë,
 - b. që kushtet e marrëveshjes përkatëse mund të ndryshojnë sa të jetë e nevojshme për t'i dhënë efekt ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe të konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe ndryshime të tilla do të jenë të detyrueshme për kundërpalën e bankës,
 - c. që aksionet e zakonshme ose instrumentet e tjera të pronësisë mund të emetohen ose t'i jepen kundërpalës së bankës, si rezultat i ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit;
4. njohjen dhe pranimin nga kundërpala se dispozita kontraktuale është shteruese për çështjet e përshkruara në të, dhe nuk cenohet nga çdo marrëveshje tjetër rregullimi ose mirëkuptimi ndërmjet palëve, në lidhje me çështjen e marrëveshjes përkatëse.

Neni 6

Detyrime të siguruara (garantuara) për të cilat zbatohet përfshirja e dispozitës kontraktore

Për qëllimet e shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016 dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 31 të këtij ligji, një detyrim nuk do të konsiderohet si një detyrim i përjashtuar dhe do të përfshijë dispozitën kontraktore sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, kur në kohën në të cilën është krijuar:

- a. nuk është plotësisht i siguruar (garantuar);
- b. është plotësisht i siguruar, por rregullohet nga dispozitat kontraktuale që nuk e detyrojnë debitorin të mbajë detyrimin plotësisht të siguruar (garantuar) në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 7

Detyrimet për të cilat zbatohet përjashtimi nga përfshirja e dispozitës kontraktore

1. Për qëllimet e pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk kërkon përfshirjen

e dispozitës kontraktuale, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, kur vlerëson se ligji i vendit tjetër në bazë të të cilit rregullohen detyrimet, ose një marrëveshje e lidhur me autoritetin përkatës të vendit tjetër, parashikon një procedurë administrative ose juridike e cila:

- a. me kërkesë të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose me iniciativë të vendit tjetër ligji i të cilit rregullon detyrimin ose instrumentin, i mundëson organit të autorizuar gjyqësor ose administrativ të vendit tjetër, brenda një periudhe që Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton se nuk ndikon në zbatimin efektiv të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit nga ai autoritet:
 - i. të njohë dhe t'i japë fuqi ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ose
 - ii. të mbështesë përmes zbatimit të kompetencave përkatëse, ushtrimin e kompetencave të zhvlerësimit dhe të konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;
- b. siguron që arsyet mbi të cilat një autoritet gjyqësor ose administrativ i vendit tjetër, mund të refuzojë të njohë ose të mbështesë ushtrimin e kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit në përputhje me shkronjën "a" më lart, janë shprehur qartë dhe kufizohen në një ose më shumë nga rastet e mëposhtme të jashtëzakonshme:
 - i. njohja ose mbështetja e ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme do të kishte efekt negativ në stabilitetin financiar për vendin e tretë,
 - ii. njohja ose mbështetja e ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme do të rezultonte në trajtimin më pak të favorshëm të kreditorëve të vendit të tretë, në veçanti të depozituesve të vendosur dhe të pagueshëm në vendin tjetër, në krahasim me kreditorët dhe depozituesit e vendosur ose të pagueshëm në Shqipëri, me të drejta të ngjashme sipas legjislacionit në fuqi,
 - iii. njohja ose mbështetja e ushtrimit të këtyre kompetencave do të kishte ndikime të rëndësishme financiare për vendin tjetër,
 - iv. efektet e njohjes ose mbështetjes së ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme do të kishin ndikim negativ në rendin publik të vendit tjetër.
2. Për qëllimet e zbatimit të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr. 133/2016, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson se arsyet

e referuara në pikën 1, shkronja "b", të këtij neni, nuk do të parandalonin njohjen ose mbështetjen e ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit në të gjitha rrethanat kur zbatohen këto kompetenca.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 21, datë 7.4.2021

PËR
DISA NDRYSHIME NË FONDIN NUMIZMATIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 11, shkronja "m", të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Kabinetit të Guvernatorit" të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 2.3.2016; me propozimin e Kabinetit të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë një shtesë në fondin numizmatik për dhurata, pjesë e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 09, datë 06.02.2008, "Për miratimin e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë", i ndryshuar, me vlerat e përcaktuara në Aneksin 1 të këtij vendimi.
2. Shtesa në fondin numizmatik për dhurata sipas pikës 1 të këtij vendimi, të kryhet duke zbatuar procedurat përkatëse mbi funksionimin e Arkës Stok.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI
GENT SEJKO

ANEKSI 1

Miratuar me vendimin nr. 21, datë 7.4.2021, të Këshillit Mbikëqyrës
së Bankës së Shqipërisë

SHTESA E FONDIT NUMIZMATIK TË DHURATAVE PËR SPECIMENET E KARTËMONEDHAVE TË REJA, PRERJA 1.000 LEKË DHE 10.000 LEKË, EMETIM I VITIT 2019

Nr.	Vlerat numizmatike	Fondi numizmatik për dhurata
	Kartëmonedha specimen	(në copë)
1	1.000 lekë, specimen, viti 2019	100
2	10.000 lekë, specimen, viti 2019	100



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 22, datë 7.4.2021

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR PËRFAQËSIMIN LIGJOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN
PËR HARMONIZIMIN E VROJTIMEVE TË BESIMIT KONSUMATOR DHE TË
BIZNESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; dhe bazuar në propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Parë, Zj. Luljeta Minxhozi, për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian, për periudhën maj 2021 – prill 2025, si dhe për nënshkrimin e të gjithë dokumentacionit në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij programi, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendim.
2. Ngarkohet Zëvendësguvernatori i Parë, Zj. Luljeta Minxhozi, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI
ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI
GENT SEJKO

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 23, NUMËR 1, MARS 2021

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 5847, datë 22.12.2020, "Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë nga subjekti financiar jobankë "Crimson Finance Fund Albania" sh.p.k."
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 5958, datë 29.12.2020, "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 13.1.2021, "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Alpha International Holdings Single Member S.A., Greqi të 100 për qind të kapitalit aksionar të Banka Alpha Albania Sh.A."
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 4, datë 13.1.2021, "Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 13.1.2021, "Për një ndryshim në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 13.1.2021, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 8, datë 3.2.2021, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 3.2.2021, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për sigurinë e informacionit""
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 3.3.2021, "Për Miratimin e "Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020""
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 14, datë 3.3.2021, "Për Miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e një dokumenti në kuadër të marrëdhënies së biznesit midis Bankës së Shqipërisë dhe institucionit Bank of America Securities INC."

